



Datë: 21.05.2025  
Numër Protokolli: 3335/2025

A.nr.701/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.701/2025, të datës 23.04.2025, të parashtruar nga ankuesja J.D-D., kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.701/2025, e datës 23.04.2025, e parashtruar nga ankuesja J.D-D.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile J.D-D.(*tutje referuar vetëm ankuesja*), fizikisht më datë 23.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos kompensimin sipas koeficientit 7.3 nga Komuna e Prishtinës si e drejtë e fituar sipas Rregullores Nr. 10.2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërsa ankuesja më datë 13.05.2025 është tërhequr nga ankesa 23.04.2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.561/2024 të datës 19.04.2024.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.701/2025**

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ankueses J.D-D.;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*